

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca Plenare

Seanca nr.2004/06

Prishtinë, më 9 prill 2004, në orën 10:10

Ndërtesa e Kuvendit, Salla e seancave plenare.

PROCES VERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Xhavit **Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 88 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

R E N D D I T E:

1. Fjala e PSSP-së, z.Hari Holkeri para deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe
2. Formimi i Komisionit parlamentar ad hoc për vlerësimin e ngjarjeve të marsit 2004.

Në fillim të seancës, **kryetari** përshëndeti praninë e PSSP-së, z.**Holkeri** dhe të zëvëdësít të tij, **Brajshou** dhe e ftoi atë t'i drejtohet deputetëve të Kuvendit.

PSSP-së, z.Hari Holkeri tha se ngjarjet e 17 dhe 18 marsit ishin tronditëse dhe të tmerrshme. Këto javë ishin ditët më të vështira për Kosovën, gjatë të cilave u vranë 19 persona u shkatruan 730 shtëpi, 29 kisha dhe manastire dhe mbi 4000 njerëz u dëbuani nga shtëpitë e tyre. E gjithë kjo dhunë e manifestuar gjatë këtyre ditëve nuk ka qenë vepër e tërë shoqërisë, por e një grapi të vogël njerëzish, të cilët planin e tyre mendojnë ta realizojnë përmes dhunës dhe kërcënimive.

Unë bashkëndjej me të gjithë ata që kane pësuar gjatë këtyre ngjarjeve, duke i perfshirë edhe familjet e fëmijëve të mbytur ne lumin Ibër në Mitrovicë. U shprehi ngushllime familjeve të atyre që humbën jetën në këtë dhunë të pakuptimitë.

Jamë këtu ta bëjmë një vlerësim të përbashkët dhe të ecim përpara dhe këtë mund ta bëjmë vetëm së bashku.

Dhuna, pavarësisht nga motivet, kushdo qoftë viktimë e saj, ajo patjetër duhet të denohet. Udhëheqësit e vërtetë të Kosovës po jepin një mesazh për pajtim dhe rindërtim të harmonisë shoqërore. Në ditët e ardhshme duhet të organizohet një takim ndërmjet udhëhesve politikë, Qeverisë dhe UNMIK-ut për të diskutuar për punët praktike për rindërtimin e besimit të humbur ndërmjet bashkësive.

Puna e përbashkët është e vetmja rrugë që të dali nga kjo fatkeqësi dhe të ecim përpara. UNMIK-u zotohet se do të vazhdojë zhvillimin ekonomik të Kosovës, të cilin me të drejtë e kërkojnë qytetarët e Kosovës dhe do të përshtypojë procesin e privatizimit.

Në dhjetor, unë dhe kryeministri i Kosovës e kemi paraqitur vizionin tonë për të ardhmen e Kosovës në planin "Standarde për Kosovën". Në një shoqëri demokratike duhet të suundojë ligji njësoj për të gjithë qytetarët e saj. Gjithashtu, duhet të respektohet shumëlojshmëria kulturore dhe etnike, stabiliteti dhe prosperiteti për të gjithë në Kosovë. Kur të plotësohen këto standarde Kosovën do ta shpien drejt një të ardhme të ndritëshe me në Evropë dhe në bashësinë ndërkombëtare.

Javën e kaluar, kryeministri Rexhepi më ka shoqëruar në shpalljen e Planit përe zbatimin e standardeve, në të cilin parashihen hapat që duhen të ndërmirren për të arritur këtë vizion.

Heronjët që i nivojiten sot Kosovës janë ata që dëshirojnë tа n dërtojnë një shoqëri të re, me të ardhme në Evropë.

Kosova ende ka shumë miq. Vizitat që u bënë, pas këtyre ngjarjeve, nga Sekretari i përgjithshëm i NATOS, nga udhëheqësit e BE-së, të SHBA-ve, tregojnë se ata dëshirojnë të arrijmë vizionin e "Standardeve për Kosovën".

Paralajmërimi i z. Grosman për formimin e një grupei mbështetës për Kosovën do të na ndihmojë që Kosova të ecë drejt së ardhmes së saj në Evropë dhe në Botë.

Kryetari i ftoi kryetarët e grupave parlamentare që t'i paraqesin qëndrimet e tyre për ngjarjet e marsit.

Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se ngjarjet tragjike të 17 dhe 18 marsit kishin përfshirë humbje jetash të njerëzve, shkatrrime materiale dhe prishje të raporteve ndërmjet njerëzve e komuniteteve, por edhe nxorën në shesh shumë probleme në Kosovë.

Ne gjykojmë dhunën si metodë të arritjeve të qëllimeve politike, por kemi në konsideratë kërkësat e arsyeshme të qytetarëve. Prandaj kërkojmë që puna jonë të mos rrëshqas në fushatë e propagandë sterile, por të jetë përpjekje për të zgjidhur problemet e Kosovës.

Është e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet kërkësave të arsyeshme të qytetarëve qofshin ato ekonomike, politike apo të ndonjë natyre tjeter dhe të mënyrës së artikulimit të tyre. Qytetarëve duhet t'u thuhet kah dhe si po shkojmë?

Qytetarët e Kosovës janë kundër dhunës dhe krimit. Mirëpo, krimi duhet të ndeshet me drejtësinë.

Institucionet e Kosovës duhet të fuqizohen dhe të marrin autoritetin për zhvillimet e ardhshme edhe në fushën e ekonomisë, të sigurisë, të drejtësisë dhe të përfaqësimit të jashtëm. Veprimet e tyre duhet të bëhen në bashkëpunim me UNMIK-un.

Ngjarjet e këtyre ditëve kanë rithëksuar se nuk janë të mira dhe se duhet të ndërrohen. Kosova nuk mund të jetë më teatër eksperimental politik.

Ridefinimi i raporteve ndërmjet UNMIK-ut dhe institucioneve të Kosovës tashmë është bërë domosdoshmëri.

Ne i përkrahim “Satandardet për Kosovën”si program zhvillimi për pavarësinë e Kosovës.

Arsim Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se ngjarjet e këtyre ditëve kërkojnë një analizë të gjithanshme të shkaqeve dhe të pasojave, e cila duhet të bëhet bashkërisht dhe kërkojmë që kriza të menaxhohet me veprim politik.

Ne e dënojmë dhunën dhe të gjitha aktet e tjera kriminale, por jemi të vetëdijshëm se është kriuar një vakum politik i cili ka mundësuar të shfaqet një mosbesim i qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës dhe të UNMIK-ut.

Institucionet e Kosovës duhet ta shqyrtojnë veprimin e deritanishëm, rezultatet e arritura dhe ngecjet. Duhet të ndërtohet një politikë shumë më aktive.

Edhe politika e UNMIK-ut duhet të shqyrtohet në segmentet kryesore: Sa po realizohet misioni i tij që e ka sipas Rezolutës 1244? dhe a po shkonë Kosova me tempon e paraparë drejt statusit final?

Ne presim që përocesi i implemetimit të Resolutës 1244 të përshpejtohet, përrarsye se mbajtja pezull e Kosovës krijon një pasiguri të përgjithshme.

Kërkojmë nga UNMIK-u ta ushtrojë pushtetin e tij në tërë territorin e Kosovës dhe të bëjë zhËrjen e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë dhe të fillojë t'i bartë kompetencat tek institucionet e Kosovës.

Ne i përkrahim projektin e “Standardeve për Kosovën” dhe kërkojmë edhe nga të tjerët të angazhohen në zbatimin e tyre, në mënyrë që viti 2005 të jetë vit i finalizimit të statusit të Kosovës.

Ne jemi për një Kosovë të bazuar në vlerat e demokracisë dhe të qytetrit, me diverzitetet etnike, kulturore dhe gjuhësore. Në këtë drejtim jemi shumë të hapët ndaj minoritetave dhe i ftojmë të gjitha ato, veçmas minoritetin serb, të integrohen brenda institucioneve të Kosovës dhe të bëjnë përpjekje legitime në Kuvendin e Kosovës për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre.

Bujar Dugolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se ngjarjet e marsit na kanë vendosur para disa dilemave: A është Misioni ndërkombëtar në nivelin e detyrës dhe a kanë bërë gjithë atë që kanë mundur institucionet e Kosovës për t'i parandaluar devijimet që janë paraqitur gjatë këtyre ditëve? Mendimi ynë është se asnjëra palë nuk e ka kryer punën e vet si duhet.

UNMIK-u ka bërë një punë të mirë kur e ka ndihmuar popullin e Kosovës për t'i ndërtuar institucionet e veta, por nuk e ka kryer detyrën e vet siç duhet në shumë raste dhe është bërë pengesë përfundimini e institucioneve vendore.

Ne shprehim gatishmërinë tonë përfundimini e bashkëpunuar edhe në të ardhmen me institucionet e bashkësisë ndërkombëtare.

Institucionet e Kosovës, UNMIK-u dhe KFOR-i nuk duhet të sillen sikur nuk ka ndodhur asgjë dhe të vazhdojnë me avazin e vjetër, por lypset të ndërtohet një partneritet i ri ndërmjet tyre.

Institucionet e Kosovës duhet t'i marrin të gjitha kompetencat përfundimini e vendit, kurse UNMIK-u të jetë në cilësinë e monitoruesit dhe të këshillëdhënsit.

Institucionet e Kosovës duhet të garantojnë sigurinë dhe barazinë e të gjitha pakicave, veçmas të asaj serbe dhe të bëjnë riparimin e dëmeve të shkaktuara nga revolta e këtyre ditëve.

Platforma “Standardet për Kosvën” duhet të definohet : Standardet për pavarësinë e Kosovës dhe integrimin e saj në strukturat Evroatlantike. Vetëm në këtë mënyrë mund ta realizojmë një projekt të përbashkët.

Gani Sadik, në emër të Grupit Parlamentar të të tjerve, tha se ngjarjet e marsit, me gjithë respektin për të drejtat e qytetarëve për të protestuar në mënyrë të qetë, na kanë lëkundër të gjithëve. Mirëpo, këto ngjarje nuk duhet të na bllokojnë në punën tonë të mëtejme, as nuk duhet ta njegullojnë të ardhmen dhe kurrsesi ta dëmtojnë partneritetin e shkëlqyeshëm me misionin ndërkombëtar në Kosovë.

Ne Kosovën e konsiderojmë vendin tonë dhe dëshirojmë që të gjithë së bashku të angazhohemi për një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët, pa dallim etnie apo feje. Nuk dëshirojmë që të mbivotohem i në rrafshin e të drejtave të njeriut dhe të barazisë etnike, por nuk dëshirojmë t'i bllokojmë proceset e vendimarrjes, kur në mënyrë demokratike, vendimet merren me shumicë votash, si çdo kund në botën demokratike.

Ardhmërinë tonë e shohim në respektimin e njëri-tjetrit dhe në integrimin e të gjitha komuniteteve në institucionet e Kosovës dhe në respektimin e tërësisë territoriale të Kosovës.

Vlersësimi dhe gjykimi i përbashkët i këtyre ngjarjeve nga të gjitha subjektet politike dhe marrja e përgjegjësive konkrete për tejkalimin e kësaj situate është rrugë e vetme që të kthehet besimi për një jetë të përbashkët ku respektohet përkatësia etnike, fetare dhe kulturore e të gjithë qyrtarëve të Kosovës.

2. Formimi i Komisionit parlamentar ad hoc për vlerësimin e ngjarjeve të marsit 2004.

Pas shqyrtimit të kësaj çështje, Kuvendi nxori këto

Përfundime:

1. Formohet Komisioni parlamentar ad hoc për vlerësimin e ngjarjeve të marsit 2004 në këtë përbërie:

1. Alush Gashi,
2. Nekibe Kelmendi,
3. Hydajet Hyseni,
4. Zylfije Hundozi dhe
5. Gani Sadik.

2. Komisioni brenda një muaji duhet t'ia paraqes Kuvendit raportin për shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve të 17 dhe 18 marsit 2004.

Kryetari e deklaroi Seancën të mbyllur në orën 11:25 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,
Akademik **Nexhat Daci**